



Analizë mbi Dënimin me Burgim të Përjetshëm


Autorë: Eranda Zekaj dhe Lavdim Makshana

Redaktor: Ehat Miftaraj

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan dhe NED-it.

Përkrahur nga:



**National Endowment
for Democracy**

Supporting freedom around the world

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Ilaz Agushi Prishtinë

E: info@kli-ks.org www.kli-ks.org

www.kli-ks.org

Nëntor, 2023

Prishtinë, Republika e Kosovës

Përmbajtja

1. Përmbledhja ekzekutive	2
2. Sanksionet Penale në Republikën e Kosovës	3
3. Dënimi me burgim të përjetshëm në Kosovë	4
3.1. Kushtet dhe kufizimet që parashihen për shqiptimin e dënimit me burgim të përjetshëm	7
3.2. Lirimi me kusht tek dënimi me burgim të përjetshëm	8
4. Statistika për dënimet me burgim të përjetshëm në Kosovë	10
5. Jurisprudenca e GJEDNJ lidhur me dënimet me burgim të përjetshëm	11
6. Dënimi me burgim të përjetshëm dhe të drejtat e njeriut në shtetet evropiane	13
7. Kategoritë e dënimit me burgim të përjetshëm në SHBA	17
8. Përfundime	20

1. Përmbledhja ekzekutive



Dënimi me burgim të përjetshëm, si dënimi më i rëndë, në mesin e sanksioneve penale të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, ka gjetur vend në këtë të fundit pas abrogimit të dënimit me vdekje me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/59, neni 1, pika 1.5 dhe 1.6 duke zëvendësuar kështu dhe dënimin me burgim afatgjatë, të përcaktuar sipas Kodit Penal të Përkohshëm të Kosovës.

Dënimi me burgim të përjetshëm paraqitet si dënimi më i rëndë në Kodin Penal që i shqiptohet një kryesi të veprës penale në Republikën e Kosovës dhe i njëjti aplikohet tek krimet më të rënda që parasheh legjislacioni penal.

Tashmë, dënimi me burgim të përjetshëm parashihet në 36 vepra penale të ndryshme, duke përfshirë, por jo dhe kufizuar në vepra penale si tradhtia ndaj vendit, gjenocidi, krimin kundër njerëzimit dhe vrasja e rëndë. Shqiptimi i këtij sanksioni kërkon që vepra penale të jetë e rëndë dhe e kryer në rrethana rënduese, apo që ajo vepër të ketë shkaktuar pasoja shumë të rënda. Në këtë drejtim, përmbushja e këtyre rrethanave nuk kërkohet të jetë kumulative, përderisa përmbushet njëra nga të dyja, duke përjashtuar ekzistimin e kufizimeve sipas nenit 41 të Kodit Penal.

Ky dënimi maksimal, për shkak të përmbushjes së kushtit 'të qenurit vepër penale e rëndë dhe e kryer në rrethana rënduese' në Republikën e Kosovës është shqiptuar nga gjykatat plotë nëntë (9) herë brenda viteve 2019-2023. Mirëpo, nga gjetjet e identifikuara të IKD, ky dënim asnjëherë nuk ka arritur formën e prerë.

Megjithatë, përkundër karakterit të përhershëm të këtij dënimi me burgim, instituti bashkëkohor i drejtësisë penale i lirimimit me kusht, ofron shpresë për lirim nga burgimi i përjetshëm. Në përputhje me nenin 90 të Kodit Penal, sigurohet mundësia e lirimimit me kusht për personin e dënuar me burgim të përjetshëm, pasi të ketë mbajtur tridhjetë

(30) vjet nga ky dënim. Mundësia për realizimin e kësaj të drejte fillohet me paraqitjen e kërkesës për lirim me kusht, përmes institucionit korrektues ku i dënuari vuan dënimin, apo drejtorit të këtij institucioni, tek Paneli për Lirim me Kusht, në përputhje me Ligjin mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.

Mundësia e rishikimit të dënimit, për lirim me kusht në bazë të legjislacionit kosovar është në përputhje me standardin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut [tutje: GJEDNJ], përkatësisht nenin 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut [tutje: KEDNJ]. Sipas GJEDNJ, rishikimi është e vetmja mënyrë për të vlerësuar dhe rivlerësuar siç duhet bazën legjitime penologjike që justifikon dënimin e shqiptuar me burgim të përjetshëm, duke i lënë në kompetencë gjykatave kombëtare të përcaktojnë formën dhe kohën e këtij rishikimi.

Megjithatë, sipas praktikës së vendosur nga GJEDNJ dhe obligimit mbi harmonizimin e legjislacionit nuk kanë arritur të veprojnë disa nga shtetet evropiane, duke bërë që forma të ndryshme të modifikuara të dënimit me burgim të përjetshëm të sfidohen nga kjo Gjykatë.

Në anën tjetër, kategoritë e dënimit me burgim të përjetshëm në SHBA ofrojnë vetëm "mundësi teorike" të zbutjes, të cilat nuk siagurojnë një perspektivë realiste për lirim të të burgosurve. Andaj, në kuptim të nenit 3 të KEDNJ, dënimet e shqiptuara nga gjykatat e Shteteve të Bashkuara nuk do të mund të konsideroheshin të reduktueshme.

2. Sanksionet Penale në Republikën e Kosovës



Legjislacioni ynë ka paraparë disa sanksione-dënime penale të cilat mund ti shqiptohen kryesit të veprës penale, për të cilin me vendim gjyqësor është vërtetuar se ka kryer një vepër penale të kundërligjshme. Me anë të sanksioneve penale kryesve të veprave penale i'u kufizohet një e drejtë, i kufizohet liria e lëvizjes, i merret një pjesë e pasurisë, i ndalohej të kryej veprime të caktuara e në disa shtete ku është i ligjshëm dënimi me vdekje, kryesit të veprës penale i merret edhe jeta.

Sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, sanksionet penale janë ndarë në katër (4) grupe kryesore; **dënime kryesore, alternative, plotësuese dhe vërejtja gjyqësore.**[1] Në dënime kryesore përfshihen, dënimi me gjobë, dënim me burgim si dhe dënimi me burgim të përjetshëm. [2] Në dënimet alternative, KPRK ka paraparë: dënimin me kusht, gjysmëlirinë, urdhrin për punë në dobi të përgjithshme. [3]

Sa i përket dënimeve plotësuese, KPRK ka paraparë tetë (8) dënime plotësuese si: heqjen e të drejtës për t'u zgjedhur, urdhrin për kompensimin e humbjes apo dëmit, ndalimin e ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik, ndalimin e ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, ndalimin e drejtimit të automjetit, marrjen e lejes së vozitjes, urdhrin për publikimin e aktgjykimit dhe dëbimin e të huajit nga territori i Republikës së Kosovës.

Të gjitha këto sanksione-dënime shqiptohen nga gjykatat ndaj kryerësve të veprave të ndryshme penale, në bazë të procedurës së përcaktuar ligjore dhe të njëjtat ekzekutohen kur vendimi i gjykatës bëhet i plotfuqishëm, pra kur i njejtë merr formën e prerë.

Vërejtja gjyqësore bën pjesë në dënimet alternative që ka për qëllim qortimin e kryesit të veprës penale. Me vërejtje gjyqësore kryesit i bëhet me dije se ka kryer një vepër penale të dëmshme dhe të rrezikshme, dhe në rast se i njëjti kryen sërish një vepër të tillë penale, gjykata do të shqiptojë një sanksion më të rëndë penal. Sipas nenit 81 dhe 82 të KPK-së, vërejtja gjyqësore mund të shqiptohet për vepra penale për të cilat është paraparë burgim deri në një vit burgim ose dënim me gjobë.

Shqiptimi një dënimi, përpos shkaktimit të pasojave në aspektin social dhe personal të kryesit po ashtu shkakton edhe pasoja juridike. Sipas Kodit Penal, konkretisht nenit 93 pasojat juridike të dënimit parashi-hen vetëm me ligj. Mirëpo, pasoja juridike të dënimit nuk ka për kryesit që ju shqiptohet gjoba apo vërejtja gjyqësore. Sipas nenit 94 të Kodit Penal [Pasojat juridike të dënimit të cilat kanë të bëjnë me ndalimin e fitimit të disa të drejtave të caktuara nuk mund të zgjasin më tepër se dhjetë (10) vjet nga dita kur dënimi është mbajtur, falur ose kur është bërë parashkrimi, nëse ligji nuk parasheh kohëzgjatje më të shkurtër për pasoja juridike të caktuara. Me fshirjen e dënimit pushojnë edhe pasojat juridike.

[1] Shih nenin 4, par 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

[2] Shih nenin 40 të Kodit Penal Republikës së Kosovës.

[3] Shih nenin 46 të Kodit Penal Republikës së Kosovës.

3. Dënimi me burgim të përjetshëm në Kosovë



Dënimi me burgim të përjetshëm është lloji i dënimit më të rëndë në Kodin Penal që i shqiptohet një kryesi të veprës penale në Republikën e Kosovës. Vendosja e një dënimi të tillë kishte ardhur pas abrogimit të dënimit me vdekje në legjislacionin tonë. Dënimi me vdekje ishte shfuqizuar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/59, [4] neni 1, pika 1.5 dhe 1.6.

[Dënimi me vdekje hiqet], [Për çdo vepër penale për të cilën sipas ligjit në fuqi në Kosovë të datës 22 mars 1989 parashihet dënim me vdekje, dënimi do të jetë me burgim ndërmjet minimumit që parashihet për atë vepër dhe maksimumit prej dyzet (40) vitesh].

Pas shfuqizimit të dënimit me vdekje, është paraparë dënimi me burgim afatgjatë në Kodin Penal të Përkohshëm të Kosovës, në kohëzgjatje prej një minimumi prej 21 vjet deri në një maksimum për 40 vjet, mirëpo me Kodin e ri penal ky dënim është ndryshuar në dënim me burgim të përjetshëm duke e larguar kufizimin prej 21-40 vite.

Koncepti i dënimit me burgim të përjetshëm edhe pse shihet si forma më ekstreme e dënimit ai konsiston në atë se ky dënim e zëvendëson dënimin me vdekje andaj i njëjti aplikohet tek krimet më të rënda që parasheh legjislacioni penal. Me këtë lloj dënimi synohet të sigurohet drejtësi për viktimat por edhe që i njëjti të shërbejë si preventivë në parandalimin e krimeve të ngjashme. Edhe pse ky lloj dënimi ndryshon në bazë të legjislacionit dhe praktikave të ndryshme të shteteve se ku zbatohet, Kosova ka zgjedhur që dënimin me burgim të përjetshëm ta ketë të pakufizuar në vite duke e lënë vetëm të drejtën e lirim-it me kusht të personit të dënuar me burgim të përjetshëm.

Në Kodin Penal aktual dënimi me burgim të përjetshëm parashihet në **36 vepra penale** të ndryshme, ku përfshihen vepra penale si tradhtia ndaj vendit, gjenocidi, krimet kundër njerëzimit, vrasja e rëndë etj.

[4] "Rregullore Nr.2000/59 për ndryshimin e Rregullores Nr. 1999/24 Mbi Ligjin në fuqi në Kosovë". UNMIK. 27 tetor2000.(Shihlinkun: https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/regulations/03albanian/A2000regs/RA2000_59.htm). (Qasur për herë të fundit më 21 gusht 2023).



VEPRAT PENALE TË DËNUESHME ME BURGIM TË PËRJETSHËM

- Pranimi i kapitullimit dhe okupimit
- Tradhtia ndaj vendit
- Vrasja e përfaqësuesve të lartë të Republikës së Kosovës
- Spiunazhi
- Veprat e rënda kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës
- Kryerja e veprës terroriste
- Gjenocidi
- Krime kundër njerëzimit
- Krime të luftës në shkelje të rëndë të konventave të Gjenevës
- Krime të luftës në shkelje të rëndë të ligjeve dhe zakoneve që zbatohen në konfliktin e armatosur ndërkombëtar
- Krime të luftës në shkelje të rëndë të nenit 3 të përbashkët të konventave të Gjenevës
- Krime të luftës në shkelje të rëndë të ligjeve dhe zakoneve që zbatohen në konfliktet e armatosura që nuk janë të karakterit ndërkombëtar
- Sulmet në konfliktet e armatosura që nuk kanë karakter ndërkombëtar kundër instalimeve që përmbajnë forca të rrezikshme
- Përdorimi i mjeteve ose i metodave të ndaluara të luftimit
- Rrëmbimi i fluturakes
- Rrezikimi i sigurisë së aviacionit civil
- Rrezikimi i sigurisë së lundrimit detar



- Rrezikimi i sigurisë së platformave fikse të vendosura në pragun kontinental
- Kontrabandimi me migrantë
- Trafikimi me njerëz
- Rrezikimi i personave nën mbrojtje ndërkombëtare
- Rrezikimi i personelit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe i personelit në marrëdhënie me to
- Marrja e pengjeve
- Përvetësimi, pranimi, shfrytëzimi, prodhimi, posedimi, transferi, ndryshimi, asgjësimi, shpërndarja ose dëmtimi i paautorizuar i materialeve nukleare apo radioaktive
- Vrasja e rëndë
- Rrëmbimi
- Dhunimi
- Shërbimet seksuale të viktimës së trafikimit
- Sulmi seksual
- Degradimi i integritetit seksual
- Pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar
- Vjedhja grabitqare
- Grabitja
- Zjarrëvënia
- Hakmarrja
- Shkelja e fshehtësisë së procedurës

3.1. Kushtet dhe kufizimet që parashihen për shqiptimin e dënimit me burgim të përjetshëm



Meqenëse, dënimi me burgim të përjetshëm e ka zëvendësuar dënimin me vdekje, edhe kushtet për shqiptimin e tij janë të ngjashme me ato të dënimit me vdekje. Kodi Penal aktual ka paraparë dy kushte kryesore^[5]:

Vepra penale të jetë e rëndë dhe e kryer në rrethana rënduese
Vepra penale të ketë shkaktuar pasoja shumë të rënda

Këto dy kushte sipas Kodit Penal nuk kërkohen të përmbushen në mënyrë kumulative, mjafton që njëri nga kushtet të përmbushet në mënyrë që gjykata të shqiptojë dënimin me burgim të përjetshëm. Po ashtu, Kodi Penal përveç kushteve ka paraparë edhe kufizime se kur mund të shqiptohet ky lloj dënimi. Sipas Kodit Penal, ky lloj dënimi nuk mund të shqiptohet në këto raste:



Grafiku 1: Kufizimet e shqiptimit të dënimit me burgim të përjetshëm

[5] Shih nenin 41 par 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

[6] Po aty, par 2 dhe 3.

3.2 Lirimi me kusht tek dënimi me burgim të përjetshëm



Lirimi me kusht është prej instituteve bashkëkohore të drejtësisë penale, që nënkupton se peroni i cili është duke mbajtur dënimin me burgim, lirohet para kohe nga burgju por me kushte të caktuara. Pra, që të mos kryhet vepër penale gjatë kohës për sa vite është shqiptuar dënimi me burgim. Nga ky institut nuk janë përjashtuar as të dënuarit që i'u është shqiptuar dënimi me burgim të përjetshëm.

Sipas Kodit Penal aktual neni 90, par 3, **[Personi i dënuar me burgim të përjetshëm mund të lirohet me kusht pasi të ketë mbajtur tridhjetë (30) vjet nga dënimi me burgim i shqiptuar. Periudha minimale e mbikëqyrjes nga ana e shërbimit sprovues do të jetë së paku pesë (5) vjet].**

Kërkesa për lirim me kusht
(pas 30 vjetësh)


Periudha mbikëqyrëse nga
SHSK (Minimumi 5 vjet)

Grafiku 2. Kërkesa për lirim me kusht pas mbajtjes së dënimit me 30 vite burg

Lidhur me lirimin me kusht të një personi të dënuar me burgim apo burgim të përjetshëm vendos Paneli për Lirim me Kusht i themeluar në pajtim me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale[7], i cili është organ në kuadër të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) dhe përbëhet nga tre (3) anëtarë, një (1) gjyqtar i Gjykatës Supreme, një (1) gjyqtar i Gjykatës së Apelit dhe një (1) zyrtar nga Ministria e Drejtësisë, e që ky komision udhëhiqet nga gjyqtari i Supremes.[8] Personi i dënuar me burgim të përjetshëm kërkesën për lirim me kusht e paraqet tek Paneli nëpërmjet institucionit korrektues në të cilin ai është duke e mbajtur dënimin.

Mirëpo, propozimi për lirim me kusht për një të dënuar mund të paraqitet edhe nga Drejtori i Institucionit korrektues. Ndërsa, sipas Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale [neni 16, par 4], pas paraqitjes së kërkesës për lirim me kusht, Drejtori i institucionit korrektues kërkon nga Shërbimi Sprovues që të vizitoj të dënuarin dhe të nënshkruaj marrëveshjen për mbikëqyrjen e tij pas lirimit me kusht.

Mirëpo, paraprakisht për tu shqyrtuar kërkesa për lirim me kusht, kërkohet që institucioni korrektues të dërgoj një raport të detajuar tek Paneli me Lirim me Kusht, ku përfshihen të dhëna të detajuara për personin e dënuar, llojin e veprës penale, të kaluarën e tij kriminale etj.[9]



Grafiku 3. Kërkesa për lirim me kusht pas mbajtjes së dënimit me 30 vite burg

[7] Neni 90, par 4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

[8] Shih: Ligji Nr. 08/L-132 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 117.

[9] Shënim: Neni 116, par 6 i Ligjit 08/L-132 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale ka paraparë se çka përfshin raporti për personin e dënuar që kërkohet lirimi me kusht, ku në raport sipas këtij neni përfshihet: 1. llojin e veprës penale të kryer nga personi i dënuar; 2. qëndrimin e personit të dënuar ndaj veprës penale, viktimës dhe familjes së viktimës; 3. ndonjë vepër penale të kryer më parë nga ai; 4. rrethanat e tij familjare dhe të kaluarën shoqërore; 5. gjendjen e tij fizike dhe psikologjike, duke përfshirë vlerësimin e rrezikshmërisë kurdo që konsiderohet e nevojshme nga një psikiatër, apo psikolog; 6. sjelljen e tij në institucionin korrektues dhe suksesin e arritur në shmangien e faktorëve të veprës penale; 7. planet e tij pas lirim; 8. përkrahja që mund t'i ofrohet pas lirim; dhe 9. ndonjë rrethanë që tregon se ai nuk do të kryejë vepër të re penale.

4. Statistika për dënimet me burgim të përjetshëm në Kosovë




Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) gjatë monitorimit sistematik që i bënë sistemit të drejtësisë ka gjetur se në Gjykatat e Republikës së Kosovës, brenda viteve 2019-2023, janë shpallur nëntë (9) akt-gjykime me burgim të përjetshëm ndaj nëntë (9) personave. Mirëpo, asnjë nga dënimet e shqiptuara me burgim të përjetshëm deri më sot nuk ka arritur të bëhet i plotfuqishëm.

Nga gjetjet e IKD-së del se në nëntë (9) rastet kur gjykatat kanë shqiptuar këtë dënim, vepra penale me të cilën akuzoheshin të akuzuarit në këto tetë raste ka qenë vepra penale **“Vrasje e rëndë”**. Këtë dënim maksimal, gjykatat e Kosovës e kanë shqiptuar ndaj të akuzuarve Shefki Spahiu, Bajram Velija, Pjetër Ndrecaj, Trimor Lalinovci, Naser Pajazitaj, Gani Kriezi, Nuhi Mavroqani, Dardan Krivaqa dhe Xhafer Bardhit.

Dënimet me burgim të përjetshëm në Kosovë të shqiptuar ndaj të akuzuarve të lartcekur, asnjëherë nuk kanë arritur të marrin formën e prerë si të tilla. Të gjitha aktgjykimet e shpallura me këtë dënim maksimal nuk e kanë arritur plotfuqishmërinë, pasi të njëjtat janë shfuqizuar nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës.

Në një rast të identifikuar nga IKD, Gjykata Supreme e ka liruar nga akuza njërin nga rastet kur ky dënim është shqiptuar, kurse në rastet tjera nga Apeli dhe Supremja dënimi është zbutur në 25-30 vite burgim.[10]



Grafiku 4. Personat e dënuar me burgim të përjetshëm 2019-2023

[10] “Nga 2019-ta tetë burra u dënuan me burgim të përjetshëm, ende asnjë dënim s’ka marrë epilog përfundimtar”. Betimi për Drejtësi. 6 gusht 2023. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/nga-2019-ta-tete-burra-u-denuan-me-burgim-te-perjetshem-ende-asnje-denim-ska-marre-epilog-perfundimtar/>). (Qasur për herë të fundit më 23 gusht 2023).

5. Jurisprudenca e GJEDNJ lidhur me dënimet me burgim të përjetshëm



Kundërshtimet në Evropë lidhur me papajtueshmërinë e dënimit me vdekje me të drejtën për jetë dhe dinjitetin njerëzor rezultuan të suksesshme përfundimisht me Protokollin e 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut [tutje: Konventa], pasi që ky dënim u zëvendësua me dënimin me burgim të përjetshëm, si dënim më i butë dhe në përputhje me të drejtat e mbrojtura nga Konventa.

Por diskutimi rreth asaj se, a është në të vërtetë dënim më i butë, lind si pasojë e natyrës së përjetshme të papërcaktuar, që privon të burgosurit nga çdo aspiratë për përmirësim duke u paraqitur kështu në dukje si e barasvlefshme me dënimin me vdekje.[11]

Në anën tjetër, Konventa nuk përmban dispozita që ndalojnë shqiptimin e dënimit të përjetshëm për personat e dënuar për krime veçanërisht të rënda, duke mos ndaluar kështu shqiptimin e të njëjtit kur ekzistojnë rrethanat sipas ligjeve të brendshme.

Por duke marrë parasysh zhvillimin e shoqërisë demokratike, përkufizimet e konventës duhet të evoluojnë. Sipas Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut [tutje: GJEDNJ] Konventa është një dokument i gjallë, që duhet të interpretohet në dritën e rrethanave të sotme që përfshijnë nenin 3 të Konventës.[12]

Në këtë drejtim, neni 3 i Konventës përcakton se **‘askush nuk duhet t’i nënshtrohet torturës ose trajtimit ose dënimit çnjerëzor ose poshtërues.’**

NENI 3

Ndalimi i torturës

Askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës ose denimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese

Kjo dispozitë përbëhet nga tri elemente kryesore „tortura“, „çnjerëzor’ dhe „poshtërues’, kuptimi i të cilave, së bashku me pasojat që ato shkaktojnë përcaktojnë se cilat veprime bien ndesh me këtë nen. Kështu, pretendimet për trajtim poshtërues dhe papajtueshmëri me dinjitetin njerëzor lidhur me burgimin e përjetshëm kanë rezultuar në jurisprudencë të rëndësishme të GJEDNJ-së për këtë çështje.

Nga sa më sipër, dënimi me burgim të përjetshëm është në përputhje me nenin 3, në rast të ekzistimit të një perspektive lirimi dhe një mundësi rishikimi. Përputhshmëria në një situatë të tillë, sipas Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut arsyetohet për shkak të tri arsyeve.

[11] Gauthier de Beco, “Dënimet e jetës dhe dinjiteti njerëzor” (2005) 9 The International Journal of Human Rights, fq. 414.

[12] Tyrer kundër Mbretërisë së Bashkuar, 25 April 1978, Seria A, nr. 26, Gjykata vendosi që ndëshkimi trupor gjyqësor i shkelësve të mitur, i cili u konsiderua i lejueshëm në vitin 1956, nuk mund të konsiderohej më i pranueshëm sipas Konventës së 1978.

Fillimisht, balancimi në mes qëllimit të dënimit, që justifikon dënimin me burgim të përjetshëm nuk është statik dhe mund të ndryshojë gjatë rrjedhës së dënimit. Kjo pasi që, arsyeja parësore për dënim mund të mos qëndroj pas një periudhe të gjatë të vuajtjes së dënimit, andaj rishikimi është e vetmja mënyrë për të vlerësuar dhe rivlerësuar siç duhet bazën legjitime penologjike që justifikon dënimin.[13]

Së dyti, nuk ofrohet mundësi rehabilitimi, pavarësisht përparimeve të të burgosurëve[14] dhe së fundmi, dënimet e tilla shkojnë në mos respektim të dinjitetit njerëzor, pasi që të privuarit nga liria nuk i ofrohet më asnjë mundësi e rifitimit të lirisë.[15]

Megjithatë, pozicionin e saj mbi regjimin e dënimit të përjetshëm të Mbretërisë së Bashkuar, Dhoma e Madhe e GJEDNJ e ndryshoi në rastin Hutchinson, duke shprehur përputhshmërinë me nenin 3 të Konventës. Kjo pasi që sipas Gjykatës, mospërputhja e evidentuar në vendimin Vinter është zgjidhur pasi Gjykata e Apelit në Mbretërinë e Bashkuar ka ofruar qartësi të mjaftueshme për kushtet në të cilat një i burgosur i përjetshëm mund të lirohet.[16]

Këto praktika të ndryshme, ofrojnë një paqartësi dhe pasiguri në paraqitjen e rasteve para GJEDNJ. Kjo pasi që ende ka hapësirë për zhvillimin e standardeve dhe parimeve të mëtejshme, sipas pikëpamjeve të ndryshme të gjyqtarëve të GJEDNJ-së dhe kufirin e vlerësimit të shteteve kontraktuese, me rastin e rregullimit të drejtave dhe detyrimeve të përcaktuara nga Konventa. Lidhur me këtë çështje GJEDNJ ka bërë të ditur se gjykatat kombëtare mund të përcaktojnë formën dhe kohën e rishikimit të dënimit të përjetshëm. [17]

[13] Vinter dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar (2013) [DHM], para. 111.

[14] Vinter dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar (2013) [DHM], par. 112.

[15] Vinter dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar (2013) [DHM], par. 113.

[16] Hutchinson kundër Mbretërisë së Bashkuar (2017) [DHM] App. 57592/08, par. 38-41.

[17] Vinter dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar, Nr. 66069/09, 130/10 & 3896/10, Aktgjykim i dhomës së madhe 9 korrik 2013, para 120, qasur më 4 qershor 2023, <http://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-122664>.

6. Dënimi me burgim të përjetshëm dhe të drejtat e njeriut në shtetet evropiane

Pavarësisht, praktikës së vendosur nga GJEDNJ, sa i përket mekanizmit të rishikimit dhe mundësisë për të rivlerësuar nëse dënimi i shqiptuar ende justifikon veprën e kryer, disa prej shteteve nuk kanë arritur të veprojnë në këtë mënyrë. Kjo ngase rrallë-herë shtetet kanë arritur të përmbushin standardet për të drejtat e njeriut.

Megjithatë, këto forma të ndryshme të modifikuara të dënimit me burgim të përjetshëm janë sfiduar me të drejtën evropiane. Në këtë drejtim, qëllimet e dispozitave të legjislacioneve të shteteve si: Hungaria, Lituania dhe Holanda, sa i përket këtyre dënimeve nuk mund të konsideroheshin në përputhje me frymën evropiane.

Praktikat mbi dënimin e përjetshëm para dhe pas vendimeve gjyqësore

Deri vonë, dënimet e përjetshme në Holandë. [18] nuk kishin asnjë mekanizëm për lirim të burgosurve, përveç faljes në emër të monarkut. [19] Përderisa, Lituania njihte faljen presidenciale pas 10 viteve vuajte dënimi. [20] Ndërsa, Hungaria, si shteti i vetëm në Evropë me dispozitë kushtetuese [21], që lejon dënimin me burgim të përjetshëm, parashihte vetëm procedura të faljes, që mezi ofronin mundësi të lirimimit me kusht.

Praktika të tilla nuk ndjekin frymën e trajtimit të burgosurve me burgim të përjetshëm të vendosur nga GJEDNJ. Kjo pasi që në këto situata fare pak ofrohet shpresë për lirim dhe mundësi të riintegritimit të të burgosurve.

Gjykata Supreme e Holandës, kishte shqyrtuar mundësinë për lirim në rastin e dënimit me burgim të përjetshëm në Holandë dhe kishte theksuar se burgimi i përjetshëm nuk mund të shqiptohet nëse nuk është e qartë në kohën e shqiptimit, se do të ketë një mundësi reale për të rivlerësuar dënimin e përjetshëm. Duke qenë në kundërshtim me jurisprudencën e GJEDNJ-së, Holanda vendosi procedurë të re të rivlerësimit pas mbajtjes së 25 viteve të dënimit, e cila përmbushte kriteret e vendosura nga GJEDNJ. [22]

E papranueshme ishte praktika e Hungarisë, e cila u detyrua të reflektoj pas vendimit të GJEDNJ-së, duke ofruar mundësi lirimimi me kusht pas 40 vjetëve vuajtje të dënimit, për të burgosurit me burgim të përjetshëm. Vlen të theksohet se edhe pas ndryshimit të vendosur, GJEDNJ nuk aprovoi këtë mundësi si shpresë për lirim, për shkak të periudhës së gjatë të rishikimit prej 40 viteve.

[18] Sipas ndryshimeve legjislative në Holandë, në bazë të vendimit të Gjykatës Supreme të Holandës, personat e dënuar me burgim të përjetshëm kanë të drejtë lirimimi me kusht pas 27 viteve burgim nga ministri i drejtësisë.

[19] Burgimi i përjetshëm dhe të drejtat e njeriut, ed. Dirk Van Zyl Smit and Catherine Appleton. 2019, fq. 53

Përderisa, e papranueshme në kuptim të nenit 3 të KEDNJ-së ishte edhe falja presidenciale, në Lituani, duke qenë se falja nuk ishte subjekt i shqyrtimit gjyqësor.

[23] Kjo pasi që mekanizmi i rishikimit duhet t'i imponojë autoritetit një detyrë për të shqyrtuar nëse arsyet legjitime penologjike justifikojnë vazhdimin e burgimit, duke mos lënë vendimin plotësisht në diskrecionin e atij autoriteti. Megjithatë, kjo çështje u adresua me ndryshimet legjislative të Lituanisë, në mars të vitit 2019. [24]

Vendimet e GJEDNJ-së për këto raste tregojnë kritikën e lartë të saj për procedurat e lirimit që shtetet ndjekin. Sipas vendimeve të kësaj të fundit, nuk përcaktohen procedura të veçanta apo të specifikohet mekanizmi për mundësi të rishikimit, por vetëm kërkohet nga shtetet të sigurojnë mbrojtje ndaj arbitraritetit; saktësi të kriterëve dhe kushteve lidhur me rishikimin e dënimit, në përputhje me sigurinë juridike dhe për aq sa është e nevojshme që i burgosuri të dijë se çfarë duhet të bëjë ai ose ajo për t'u marrë në konsideratë për lirim.

Ndryshe me sa më sipër, GJEDNJ, në situatën e Francës, përkatësisht rastin Bodein kundër Francës konstatoi se shqyrtimi i kërkesave të burgosurve për lirim me kusht nga një gjykatë e specializuar pas mbajtjes së 30 vjetëve burgim, është i mjaftueshëm për qëllimet e nenit 3 të KEDNJ-së. Duke shprehur se kjo periudhë e rishikimit të dënimit nuk është aq larg përtej periudhës së saj të preferuar prej njëzet e pesë vjetësh sa të jetë e papranueshme. [25]

Në anën tjetër, idea e përjashtimit të dënimit me burgim të përjetshëm ngritej vazhdimisht në Skandinavi. Kjo pasi që në praktikë, dënimi i përjetshëm nuk kishte qenë kurrë një dënim i vërtetë i përjetshëm, pasi gjithnjë përfundohej përmes faljes. Dhe në anën tjetër, binte ndesh me parimet themelore të rehabilitimit dhe riintegritimit.[26]

Megjithatë, përmes ligjit për zbutjen e dënimeve të përjetshme në Suedi, ky dënim u zbut aq shumë, sa që largimi i tij nuk ishte mjaftueshëm i nevojshëm. Kështu, në Suedi dënimi me burgim të përjetshëm teknikisht nuk ka datë të përfundimit, por të dënuarit kanë të drejtë të aplikojnë për të ndryshuar dënimin e tyre të përjetshëm në një dënim me kohë të caktuar, pasi të kenë kryer të paktën dhjetë vjet burg. Të dënuarit e përjetshëm, në rast refuzimi, mund të riaplikojnë pas një viti tjetër ose të apelojnë në Gjykatën e Apelit, duke mos përjashtuar këtu dhe mundësinë e lirimit përmes faljes.

Duhet theksuar se nëse Gjykata vendos të ndryshojë dënimin e përjetshëm në një dënim me afat të caktuar, dënimi i ri nuk duhet të jetë më i shkurtër se dënimi më i gjatë i përcaktuar nga sipas ligji suedez, i cili është tetëmbëdhjetë vjet. [27]

[20] Matiošaitis dhe të tjerët kundër Lituanisë, GJEDNJ (apps. 22662/13, 51059/13, 58823/13, 59692/13, 59700/13, 60115/13, 69425/13 and 72824/13), Maj 23, 2017.

[21] Ligji themelor i Hungarisë, neni. 4(2).

[22] HR no. S 15/00402, December 19, 2017. Burgim i përjetshëm – analizë globale e të drejtave të njeriut, Dirk Zyl Smit, Catherine Appleton, 2019. p.54.

Përderisa Norvegjia, nuk ka asnjë dispozitë mbi një dënim zyrtar me burgim të përjetshëm. Por, gjykata mund të urdhërojë “burgimin parandalues” të rinovueshëm përjetësisht përtej dënimit maksimal të caktuar prej 21 vjetësh (se tridhjetë vjet në rastin e terrorizmit) nëse ai vazhdon të paraqesë rrezik për shoqërinë. [28]

Rast konkret i shqiptimit të dënimit të tillë është rasti i Anders Behring Breivik. Për vrasjen e 77 personave, u dënua me dënimin maksimal, një afat të caktuar prej 21 vjetësh (njëzet e një). Megjithatë, dënimi i tij parashikonte që, pasi të ketë vuajtur afatin e caktuar, ai do t'i nënshtrohet një ndryshimi, domethënë, formës norvegjeze të burgimit parandalues pas dënimit, i cili mund të zgjatet në mënyrë të përsëritur deri në pesë vjet, për sa kohë që ai konsiderohet ende një rrezik për shoqërinë.[29] Ky sistem i dyfishtë i dënimit në institucionet e specializuara, i rregulluar sipas legjislacionit të brendshëm njihet edhe në shtetet tjera si Franca, Gjermania dhe Suedia. [30]

E drejta e rehabilitimit social, zhvillim ky i GJEDNJ-së, ishte paraparë për herë të parë nga Gjykata Kushtetuese Federale Gjermane, kur më 1977 vendosi se për t'i ofruar të dënuarve me burgim të përjetshëm një mundësi risocializimi kërkohej një procedurë lirimi me ligj, duke konsideruar kështu procedurat e faljes si të mjaftueshme. [31]

Kështu, në përputhje me kushtet për lirim të vendosura sipas nenit 57a të Kodit Penal Gjerman, të burgosurit që vuajnë dënimin e përjetshëm mund t'u rishikohet dënimi pas 15 viteve, me ç'rast gjykata që merr vendimin e lirim të është e detyruar të marrë parasysh seriozitetin e fajit të të burgosurit, duke dhënë kështu njëkohësisht një prognozë të favorshme, sa i përket rrezikshmërisë nga të burgosurit. Në rastet kur konstatohet se lirim është i justifikueshëm sipas interesave të sigurisë së publikut, gjykata urdhëron lirim të të burgosurit. Kjo prognozë sigurohet para arritjes së pikës prej 15 viteve, në mënyrë që Gjykata për ekzekutimin e dënimeve të vëzhgojë nëse i burgosuri është i aftë të veprojë në një shoqëri të lirë.[32]

[23] Matiošaitis dhe të tjerët kundër Lituaniës, ECtHR (apps. 22662/13, 51059/13, 58823/13, 59692/13, 59700/13, 60115/13, 69425/13 and 72824/13), Maj 23, 2017. Para. 130.

[24] Shih për më shumë: Dardanskis kundër Lituaniës - procedura e zbutjes së dënimit të përjetshëm është në përputhje me kërkesat e nenit 3.

[25] Bodein kundër Francës, GJEDNJ, nr. 40014/10, nëntor 13, 2014.

[26] Këshilli Kombëtar Suedez për Parandalimin e Krimin, 1977, f. 37

[27] Schartmueller, Doris. "Shumë e rrezikshme për të dalë jashtë? Përdorimi i mekanizmave të lirim të individualizuar për shkelësit e burgosur gjatë gjithë jetës në Suedi." Rishikimi i politikës së drejtësisë penale 25, nr. 4 (2014): 407-431.

[28] Burgimi parandalues zbatohet vetëm për disa vepra të rënda dhe mund të shqiptohet vetëm “kur një dënim për një afat të caktuar konsiderohet i pamjaftueshëm për të mbrojtur jetën, shëndetin ose lirinë e të tjerëve”: Kodi Penal 2015, para. 39c. Tapio Lappi-Seppälä, “Burgëzimi i përjetshëm dhe institucionet përkatëse në vendet nordike”, në Burgimi i përjetshëm dhe të drejtat e njeriut.

Në këtë drejtim, në Evropë ekzistojnë praktika që ndihmojnë në përgatitjen e të burgosurve me burgim të perjetshëm për lirim në fund të dënimit të tyre. Kështu, të burgosurit lejohen të largohen nga institucioni çdo ditë, për të punuar, për ndjekur kurse arsimore, ose thjeshtë për të mbajtur kontakte familjare (për shembull, në Belgjikë, Danimarkë, Finlandë, Gjermania dhe Suedia), pasi të kenë mbajtur 10 vjet burgim. [33]

[29] “Breivik i dënuar me paraburgim të përhershëm”, <http://www.domstol.no/no/Enkelt-domstol/22-7/Nyheter-om-227-saken/Breivik-convicted-to-permanent-detention>. Shih gjithashtu Catherine Appleton, “Terrorizmi i Ujku të Vetmuar në Norvegji”, *Gazeta Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut* 18 (2014) 127–142.

[30] Francë: Kodi i Procedurës Penale, nenet. 706–53–13 deri në 706–53–22; Danimarkë: Kodi Penal, § 70; Holanda: Kodi Penal, neni. 37a; dhe Suedia: Kodi Penal, kap. 31, s. 3.

[31] Vendim i Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane, BVerfGE 45, 187

7. Kategoritë e dënimit me burgim të përjetshëm në SHBA



Nocioni i dënimit të përjetshëm arriti popullaritetin e tij me ndalimin e dënimit me vdekje [32] nga viti 1972 deri në 1976. [33] Këto ndryshime në shqiptimin e dënimit me vdekje ndikuan në zhvillimin e dënimit me burgim të përjetshëm në tri drejtime. [34]

-Së pari, dënimi me burgim të përjetshëm, posaçërisht ai pa mundësi lirimi me kusht, konsiderohej si alternativë e pranueshme e dënimit me vdekje. [35]

-Së dyti, u paraqiten sfida të shumta rreth proporcionalitetit ndaj llojeve të dënimeve të përjetshme të vendosura ndaj të rriturve. Testi i proporcionalitetit për kushtetutshmërinë e dënimeve të përjetshme u njoh për një kohë në ligjet e shteteve amerikane, megjithatë me kalimin e kohës kufizimi i burgimit të përjetshëm pushoi së qeni efektiv. [36]

-Së treti, zhvillimi në përcaktimin si jo kushtetues të dënimit me burgim të përjetshëm pa mundësi lirimi me kusht ndaj të miturve, për veprën e kryer nga pakujdesia. [37]

Shqiptimi i dënimeve të cilat prekin të drejtat e njeriut parashihet me instrumente ndërkombëtare. Mirëpo, traktatet e të drejtave të njeriut nuk janë domosdoshmërisht vetë-ekzekutuese dhe për këtë arsye në disa sisteme ligjore ato nuk zbatohen drejtpërdrejtë. Në këtë drejtim, Shtetet e Bashkuara ndëshkueshmërinë e dënimeve e bazojnë në ndalimet kushtetuese vetëm në masën (e kufizuar) që trajtimi ose ndëshkimi konsiderohet "mizor dhe i pazakontë". Përkatësisht, dënimet duhet shqiptuar sipas kuptimit të amendamentit 8 **"nuk do të kërkohet lirimi i tepruar me kusht, nuk do të vendosen gjopa të tepërta, as dënime mizore dhe të pazakonta"**.

[32] Shënim: Dënimi me vdekje është ende i pranishëm në 24 shtete si: Alabama, Arizona, Arkansas, Florida, Georgia, Idaho, Indiana, Kansas, Kentucky, Louisiana, Mississippi, Missouri, Montana, Nebraska, Nevada, North Carolina, Ohio, Oklahoma, South Carolina, South Dakota, Tennessee, Texas, Utah, Wyoming.

[33] Furman kundër Gjeorgjisë 408 U.S. 238 (1972): Furman kundër Gjeorgjisë (1972) është një rast i Gjykatës Supreme të SHBA-së në lidhje me ndalimin e Amendamentit të Tetë për dënimin mizor në rastet e dënimit me vdekje. Pas këtij vendimi, përdorimi i dënimit me vdekje u pezullua ndërsa shtetet rishikuan statutet penale për të siguruar që dënimi me vdekje të mos zbatohet në mënyrë arbitrare ose diskriminuese. Gregg kundër Georgjisë 428 US 153 (1976): "Greg kundër Gjeorgjisë është një çështje e Gjykatës Supreme të SHBA-së në të cilën u gjykua se dënimi me vdekje për vrasje nuk ishte në vetvete një dënim mizor dhe i pazakontë i ndaluar nga Amendamenti i Tetë dhe i Katërbëdhjetë. U konstatua se Amendamenti i Tetë duhet të interpretohet në një mënyrë dinamike dhe fleksibël për t'u përshtatur me standardet në zhvillim të mirësjelljes." Gjykata Supreme konstatoi se dënimi me vdekje mund të vendosej nëse zbatoheshin kritere të sakta në lidhje me faktorët rëndues dhe lehtësues, në përputhje me standardet procedurale të kushtetutës federale. Pasi që dënimi me vdekje, që do të shqiptohej garantonte përputhshmëri me kushtetuten vetëm kur i njëjti është proporcional me veprën e kryer.

Burgimi i përjetshëm në Shtetet e Bashkuara në përgjithësi është një aspekt kompleks i sistemit të drejtësisë penale që ka evoluar me kalimin e kohës dhe ndryshon ndjeshëm nga shteti në shtet. Analizimi i dënimit me burgim të përjetshëm në SHBA përfshin shqyrtimin e faktorëve të ndryshëm, duke përfshirë kontekstin e tij historik, kuadrin ligjor dhe ndikimin shoqëror.

Shqyrtimi dhe trajtimi i kuadrin ligjor të burgimit të përjetshëm paraqet një ndër aspektet kritike të sistemit të drejtësisë penale në SHBA. Burgimi i përjetshëm kategorizohet në dy lloje kryesore, a) burgim i përjetshëm pa mundësi lirimi me kusht dhe b) burgim i përjetshëm me mundësi lirimi me kusht. Prej nga rrjedhë se, përshtatshmëria e lirit me kusht paraqet kushtin thelbësor në mes këtij dallimi.

Kur jemi tek dënimi me burgim të përjetshëm pa mundësi lirimi me kusht, përjashtimisht Alaskës, çdo shtet tjetër në SHBA, duke përfshirë këtu dhe sistemin federal, kanë dispozita që i referohen këtij dënimi.

KATEGORIA 1

Burgim i përjetshëm pa mundësi lirimi me kusht

Duke qenë se dënimi me burgim të përjetshëm pa mundësi lirimi me kusht, paraqitet në forma të ndryshme në SHBA, kompetencat e ndërhyrjes për lirim e të burgosurve që vuajnë këtë dënim janë të eliminuara ose të kufizuara, në një masë që praktikisht janë të pakuptimta.

Në kuptimin e Gjykatës Supreme të SHBA-së, dënimi me burgim të përjetshëm pa mundësi lirimi me kusht, nuk ishte me të vërtetë pa mundësi lirimi. Gjykata Supreme në vendimin e vitit 1974 në çështjen Schick kundër Reed, konsideroi se ekzistonin mjete juridike të lirit me kusht përderisa ekzistonte mundësia e faljes së plotë nga Presidenti apo largimi i kushtit të “mos lirit me kusht” nga dënimi me burgim. [38] Qasje të ngjashme kishte edhe në vitin 1987 në rastin Harmelin kundër Michiganit, ku konsideroi si jo shumë disproporcionale dënimin me burgim të përjetshëm pa mundësi lirimi me kusht, për posedim të drogës. Kjo pasi që shteti kishte mjete të pranishme për të shmangur ose korrigjuar dënimet e padrejta përmes faljes. [39]

[34] Burgimi i përjetshëm – Një analizë globale e të drejtave të njeriut, Dirk Zyl Smit, Catherine Appleton, 2019.

[35] Carol S. Steiker dhe Jordan M. Steiker, Hapja e një dritareje apo ndërtimi i një muri? Efekti i Amendamentit të Tetë të Ligjit të Dënimit me Vdekje dhe Avokimi mbi Drejtësinë Penale më gjerësisht,

,Universiteti i Pensilvanisë, Revista e së Drejtës Kushtetuese, 11 (2008–2009): 155–205.

[36] Solem kundër Helm, 463 SHBA 277 (1983)

[37] Graham kundër Florida, 560 SHBA 48, 81 (2010).

[38] Schick kundër Reed, 419 SHBA. para 256-268 (1974)

[39] Harmelin kundër Michigan, 501 SHBA. para 957-1008 (1991)

Megjithatë, kjo qasje është paksa më e zbutur kur subjekti i dënimit është i mituri. Koncepti i proporcionalitetit, si pjesë qendrore e amendamentit të tetë (8) dhe faktorët si “kapacitete të zvogëluara dhe perspektiva më të mëdha për reformë” [40], që përcaktojnë fëmijët si kushtetutshmërisht ndryshe nga të rriturit për qëllime të dënimit, përjashtuan shqiptimin e dënimit me burgim të përjetshëm pa mundësi lirimi me kusht për të mitur në rastet e veprave të kryera nga pakujdesia. [41] Por, këta faktorë nuk ndikuan në ndalimin e shqiptimit të këtij dënimi për të miturit në rastet e vrasjeve. [42]

Në anën tjetër në SHBA është i pranishëm dënimi me burgim të përjetshëm me mundësi lirimi me kusht. Duke qenë se këto dënime kanë periudha minimale përpara se lirimi të mund të konsiderohet, gjykata që vendos një dënim të tillë duhet të zbatojë legjislacionin për përcaktimin e afatit minimal për t’u vuajtur.

KATEGORIA 2

Burgim i përjetshëm me mundësi lirimi me kusht

Gjatë shqyrtimit të dënimit gjykata mund të ushtroj diskrecionin e saj, në bazë të natyrës së veprës penale dhe jo vetëm atyre aktuale, por edhe të veprave të mëparshme, duke vendosur në mes intervalit prej 15-25 vjet. [43] Përderisa, varësisht nga natyra e veprës penale ky interval mund të reduktohet. [44]

[40] Për faktorët e lartëcekur, shih Roper, 543 SH.B.A. para. 568–75.

[41] Graham kundër Floridës, 560 SH.B.A (2010). para. 48.

[42] Miller kundër Alabamës, 567 SH.B.A (2012). para. 482-483.

[43] Ligji Penal i Nju Jorkut. para 70.10 - 70.00 (2017).

[44] Populli Kundër Smart, 100 A.D.3d 1473, 954 N.Y.S.2d 322 (2012), aff’d, 23 N.Y.3d 213, 12 N.E.3d 1061 (2014).

8.Përfundime

Nga analiza e mësipërme e rasteve të sfiduara në GJEDNJ mund të thuhet se mbijetesa e dënimit me burgim të përjetshëm pa mundësi lirimi nuk është e sigurt. Nëse marrim për bazë elementet përbërëse të nenit 3 të KEDNJ “askush nuk duhet t’i nënshtrohet torturës ose trajtimit ose dënimit çnjerëzor ose poshtërues,” vështirë do të shmangnim cenimet e të drejtave themelore të njeriut. Kështu, në frymën e interpretimeve të vendimeve gjyqësore është e pa argumentueshme ofrimi i rishikimit mbi vlerësimin e lirit me kusht nga shtetet. Kjo nuk do të thotë se mundësia për rishikim të dënimit do të çojë gjithmonë në uljen e dënimit, pasi që i njëjti mund të na dërgoj në konstatimin se nuk ka bazë për uljen e dënimit.

Ndërsa, nëse do të tërhiqim një paralele në mes dënimeve të shqiptuara nga Shtetet e Bashkuara dhe shteteve evropiane, vështirë se këto të parat do të mund të konsideroheshin të reduktueshme për qëllimet e nenit 3 të KEDNJ-së.

Kjo pasi që, dënimet me burgim të përjetshëm pa mundësi lirimi në shtetet amerikane ofrojnë vetëm “mundësi teorike” të zbutjes dhe nuk sigurojnë një perspektivë realiste për lirim të të burgosurve. Dalueshmëria e trajtimit të rasteve të dënimeve me burgim të përjetshëm paraqitet në çështjen e ekstradimit në Shtetet e Bashkuara, në rastin Trabelsi kundër Belgjikës. Sipas këtij të fundit, ekstradimi në një shtet ku mundësia e vetme për lirim pas dënimit me burgim të përjetshëm është përmes faljes presidenciale ose zbutjes së dënimit, paraqet mekanizëm jo adekuat për rishikimin e këtij lloji të dënimit.

Ndërsa, sa i përket Republikës së Kosovës, legjislacioni penal ka ofruar mekanizma për lirim të të dënuarve me burgim të përjetshëm duke themeluar Panelin për Lirim me Kusht. Në linjë me jurisprudencën e GJEDNJ-së është lejuar mundësia që i dënuari me burgim të përjetshëm të mund të lirohet me kusht në mënyrë që të mos cenohet neni 3 i KEDNJ-së.

Andaj, sigurimi i një mekanizmi për rishikim siç e ka edhe sistemi juridik i Republikës së Kosovës është në përputhje me të drejtat themelore të njeriut dhe ofrimin e mundësisë për risocializim, si qëllimi kryesor i të drejtës penale.



